



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1764/5 Prot.

Tiranë, më 02.12.2020

V E N D I M

Nr. 53 datë 02.12 2020

PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË KOMISIONEVE DHE GRUPEVE TE PUNËS
MBËSHTETËSE PËR AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Në mbështetje të pikave 3 dhe 4 të nenit 3, nenit 38, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH “, Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, VKM nr. 329 datë 12.04.2017 “Për statutin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” Udhëzimit 29 datë 10.09.2018 ”Për veprimat dhe ngarkesën mësimore , të personelit akademik në IAL”, Rregulloren financiare dhe të shpërndarjes së të ardhurave”, miratuar me Vendim BA nr. 35 datë 21.10.2019, në Vendimin e Senatit nr.49 datë 27.11.2020 ”Për propozimin për pagesën e komisioneve dhe grupeve të punës mbështetëse për akreditimin e programeve të studimit, në UST” Relacionin përkatës, Bordi i Administrimit

V E N D O S I:

1. Të miratojë pagesën për pjesmarrje në komisione të vlerësimit të brendshëm, në njësitë kryesore, grupeve mbështetëse të punës, si dhe stafit akademik të angazhuar për përkthimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm, në procesin e akreditimit të programeve të studimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas tabelës bashkëngjitur:
2. Shpenzimet për pagesën e tyre mbulohen nga të ardhurat e Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në www.ust.edu.al dhe tek portali i transparencës universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Hysen Dëmi

